

Dalës-izlazno:

Nr. -1-16
Br. _____

Data 09.02.2023
Datum _____

OBILIQ - OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 53, të Ligjit nr. 03 / L-040, nenit 62 të Statutit të Komunës, thërras:
Mbledhjen e Komitetit për Komunitete për dt.15.02.2023, (e mërkurë) në ora 10:00 me këtë:


REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë lidhur me Planin e Veprimit për rregullimin e rrugëve me zhavorr
4. Informatë nga ZKKK-ja lidhur me raportin vjetor të kësaj zyreje për vitin 2022
5. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit për Komunitete

Faton Beka



Dalës i llozës:

Nr. -1-17
Br. _____

Data 09.02.2023
Datum _____

OBILIĆ OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për komunitete, të mbajtur me dt.20.01.2023 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Avdyl Mustafa, Florije Jashari, Faton Beka, Haki Abazi, Biljana Spasic, Valbonë Beka, Sanela Mackic, Lulzim Preniqi dhe Predrag Micalovic

Të pranishmit tjerë: Labearta Mjeku, zyrtare për kthim të qëndrueshëm, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, përf, e UNMIK-ut, përf, e KFOR-it dhe përf. e OSBE-së

Mbledhjen e udhëhoqi Faton Beka, kryesues i Komitetit për komunitete, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022
4. Informatë nga ZKKK-ja lidhur me raportin vjetor të kësaj zyreje
5. Të ndryshme

Kryesuesi – Para se të filloj me rendin e ditës, e ndjej obligim moral një keqardhje për rastet e vërshimeve që kanë ndodhë në Komunën e Skënderajit dhe uroj që kjo të kalon sa më shpejtë, të mos prekun edhe Komunitat tjera.

Pastaj, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, duke thënë lidhur me pikën e 4 të rendit të ditës se shefi i ZKKK-së, nuk është prezentë dhe po ashtu, kam biseduar edhe me znj. Myrvete Paloji, e cila më njoftoi se është e sëmurë nga gripi dhe fare nuk ka ardhë në punë, Prandaj, nëse jeni të pajtimit edhe ju që këtë pikë ta shtyejmë për mbledhjen e ardhshme.

Miratohet rendi i ditës unanimisht me ndryshimin që pika e 4 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet unanimisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Në mbledhjen e kaluar e kemi formuar një Komision për përpilimin e raportit vjetor të Komitetit për komunitete dhe unë i falënderoj anëtarët e Komisionit si dhe z.Avdyl Mustafa, pasi që deri në shtator ka qenë kryesues dhe punën më të madhe e ka bërë. Raporti vjetor i punës të Komitetit për komunitete ka për qëllim me informue Kryetarin e Komunës dhe kryesuesen e Kuvendit për të gjitha takimet që i mban Komiteti për komunitete. Në vitin 2022 janë mbajtur gjithsejtë 11 seanca të rregullta duke filluar nga muaji shkurt me zgjedhjen e kryesuesit të Komitetit për komunitete. Këtë mbledhje e ka kryesue kryesuesja e Kuvendit komunal znj.Vlora Mjekiqi Kabashi. Në mbledhjen e njejtë është zgjedhë z.Abdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete. Në muajin mars Komiteti ka formuar 2 Komisione, një Komision ishte për hartimin e planit punues për vitin 2022, dhe Komisioni i dytë ka qenë për hartimin e raportit vjetor të Komitetit për komunitete. Të 2 Komisionet e kanë krye punën me sukses dhe në muajin prill këto 2 dokumente që janë shqyrtuar dhe miratuar nga Komiteti. Mirëpo, në muajin gusht z.Avdyl Mustafa, ka dhënë dorëheqje, ndërsa në shtator është zgjedhë kryesuesi i ri z.Faton Beka. Gjatë mbledhjeve që i kemi mbajtur Drejtoritë e ndryshme komunale kanë dhënë informata si Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë, Drejtoria e shëndetësisë, urbanizmit, ZKKK-ja, etj. Në muajin qershor kemi marrë një rekomandim për shqyrtimin e shtimit të personelit për përkthim dhe mbajtjen e procesverbalit. Ne kemi kërkuar çdo herë që të shtohet personeli për arsye të vëllimit të punëve. Një nga sfidat e Komitetit ishte ndihma teknike, gjegjësisht kushtet për inçizim të mbledhjeve dhe të ftohtit gjatë dimrit. Për shkak të problemeve teknike nuk kemi pasë procesverbal në disa mbledhje, por punën e kemi vazhduar edhe pa procesverbal. Po ashtu, ka pasë mungesa të përgjegjeve me shkrim nga Kuvendi për rekomandimet, përveç kur kemi takuar me kryesuesen e Kuvendit na kanë tregue se nuk janë mundësitë buxhetore për realizimin e atyre kërkesave. Gjatë këtij viti kemi pasë shumë sfida dhe i kemi trajtuar shumë çështje dhe nevojat e ndryshme të qytetarëve të gjithë territorit të Komunës së Obiliqit. Ne kemi kërkuar që të gjitha mbledhjet e mbajtura të publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit dhe në rrjetet sociale. Një prej kërkesave është që të pajisemi me kartat identifikuese të gjithë anëtarët e Komitetit, që të iu sigurohet e drejta e përbashkët të gjitha komuniteteve me anëtarët gjatë ditëve kombëtare. Në fund të rregullohet ngrohja për periudhën ardhshme dimërore. Pra, ky është raporti vjetor që do të dërgohet kryesues së Kuvendit komunal.

Avdyl Mustafa – Në fillim dua të kërkoj falje për përkthimin në serbisht, pasi ka disa gabime teknike. kështu që ne do të kujdesemi për të. E dyta është që unë do t'i sugjeroj kryesuesit që rekomandimet që i kemi thënë në raport psh rekomandimi nr 6 sa i përket ngrohjes e kanë rregulluar tashmë, por le të jenë edhe këto rekomandime të diskutohen në Kuvend, ose ta njoftojmë kryesuesen e Kuvendit dhe ajo t'i njoftojë anëtarët e tjerë.

Sa i përket kartelave, do të ishte mirë sepse ne e kemi kërkuar vite më parë, nga arsyet se ne si anëtarë të Komitetit, ne mund të kishim qasje në Ministri, në qeveri ose gjatë, që të mund të sillnim dhe donatorë apo projekte.

Kryesuesi – Pajtohem me ju, se rekomandimet i kemi cekë edhe në vitet e kaluara. Ne do të diskutojmë bashkarisht edhe me kryesuesen dhe të shohim mundësinë e pajisjes me kartelat dhe rekomandimet që i ceka më heret.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ne kemi biseduar në mbledhjen e kaluar me disa prej anëtarëve me z.Avdyl dhe z.Haki, se si është mundësia të iu ndihmojmë rasteve sociale të komunitetit shumicë dhe pakicë. Pra, pasi që kemi në këtë krizë me iu ndihmue me nga 1 metër dru dhe kam bisedue me drejtoreshën e DSHMS-së, por ajo më njoftoi se kjo çështje duhet të kalojë përmes Drejtorisë së shërbimeve publike. Nëse, jeni të pajtimt edhe ju që të iu ndihmojmë këtyre rasteve sociale ne mund të marrim rekomandim. Ndoshta, jeni në dijeni edhe ju se Drejtoria e shëndetësisë e ka bërë një njoftim për shpërndarjen e disa subvencioneve për të sëmurët dhe munden me aplikue. Prandaj, iu kisha lutë të gjithë anëtarëve që dijnë, apo kanë ndonjë rast ti njoftojnë të aplikojnë për këto

subvencione.

Haki Abazi – Është e vërtetë, kryesues se e kemi diskutuar çështjen e gjendjes sociale si të komunitetit pakicë, ashtu edhe të komunitetit shumicë, duke parë çdo ditë situatën jo të mirë ekonomike. Ne çdo vit kemi kërkuar, por nuk është realizuar sepse kjo Drejtori nuk ka pasë lloj ndihme për dru që me i mbështetë këto \ familje, kështu që jemi dakorduar që të bisedojmë me drejtoreshën. Tani mund të bëjmë një rekomandim Drejtorisë së shërbimeve publike, që është e nevojshme për të gjitha familjet që janë me asistencë sociale dhe dihet që gjendja e tyre nuk është e mirë. Nëse, është mundësia me përkrahë i përkrahim dhe nëse, nuk është mundësia atëherë besoj se delë dikush dhe iu ndihmon këtyre familjeve. Ju njoftoj sa i përket vërshimeve për komunitetin ku unë

banoj nuk kanë probleme me vërshime dhe gjendja e tyre është e mirë. Besoj se edhe Komuna jonë dhe Komunat tjera, do të kalojnë situatën prej këtyre vërshimeve.

Avdyll Mustafa – Unë mendoj se kryetari i Komisionit duhet të bisedojë me drejtorin për çështje publike dhe më pas duhet të përgatisim një listë, numrin e familjeve që janë më të rrezikuara dhe në nevojë.

Qendra për punë sociale të përfshihet në këtë proces, por para së gjithash duhet të kemi informacion nga Drejtorja për shërbime publike, nëse e kanë në program, nëse kanë buxhet dhe nëse e mbështetin, atëherë mund të vazhdojmë.

Kryesuesi – Edhe unë pajtohem me ju sepse edhe nëse, do të kishim marrë ne rekomandim gjithsesi është dashur me diskutue me drejtorin. Propozoj se listat e familjeve në nevojë nuk kishte me qenë e rrugës me i bë, sepse mund të gabojmë, por me bashkëpunue me Qendrën për punë sociale, për rastet sociale që janë duke i përfshirë të gjitha komunitetet dhe ato me u përkrahë.

Mbledhja përfundoi në ora 10:42'

Procesmbajtësja



Azize Zeneli

Kryesuesi i Komitetit për komunitete



Faton Beka